



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK
PER MINIERAT DHE INDUSTRIE
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 2082

Tirane, date 23/2/2015

Drejtuar: Shoqëria "Albcanaj" Shpk
Lagjia Drita

BURREL

Për dijeni: Shoqëria "Global Interprise Group" shpk
Fshati Klos,

BURREL

Lënda: Njoftim mbi fillimin e procedurave për ndryshimin e koordinatave të lejes minerare nr.481/1, datë 02.08.1999.

I nderuar Z. Canaj,

Shoqëria "Albcanaj" shpk është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.481/1, date 02.08.1999, për shfrytëzimin e mineralit të kromit në objektin Theken, Qarkun Dibër.

Në zbatim të nenit 47, pika a1, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me kërkesë të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (MEI), struktura përgjegjëse, AKBN me shkresën nr.2200/1, date 16.02.2014 ka dërguar dokumentacionin e verifikimeve të mbivendosjeve të lejeve minerare në zonën e Bulqizës, si dhe ka propozuar ndryshimet që duhen bërë në koordinatat e lejes tuaj nr.481/1, datë 02.08.1999, për të shmangur mbivendosjen me lejen minerare nr.1497, datë 13.12.2010.

Koordinatat dhe sipërfaqja e zonës minerare e cilat do të hiqet nga sipërfaqja e miratuar e lejes minerare nr.481/1, datë 02.08.1999, është si më poshtë:

Koordinatat e zonës minerare (I) e cila
do të hiqet nga sipërfaqja e lejes
minerare nr.481/1

Koordinatat e Mbivendosjes		
Nr	Y	X
1	44 36 054	45 92 397
2	44 36 140	45 92 420
3	44 36 390	45 91 800
4	44 36 094	45 91 418
5	44 35 823	45 91 914
S = 0.308 km ²		Kuota +1360 – +1400 m

Koordinatat e zonës minerare (II) e cila
do të hiqet nga sipërfaqja e lejes
minerare nr.481/1

Koordinatat e Mbivendosjes		
Nr	Y	X
1	44 35 850	45 91 220
2	44 35 710	45 91 070
3	44 35 704	45 91 068
4	44 35 580	45 91 111
5	44 35 464	45 91 573
6	44 35 452	45 91 699
S = 0.1033 km ²		Kuota +1360 – +1400 m

Sa me sipër, në zbatim të nenit 47, pika a1, të ligjit nr.10304, datë 22.06.2012, “Për sektorin
minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ju njoftojmë se ka filluar procedura e
ndryshimit të koordinatave të lejes minerare nr.481/1, datë 02.08.1999, për të shmangur
mbivendosjen si me sipër.

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim do të merret vendimi për ndryshimin
e koordinatave të lejes minerare si me sipër.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

